



Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Raporti i parë vjetor

8.6. - 31.12.2010

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

PËRMBAJTJA

Parathënie:.....	1
1. Hyrje	3
1.1. Themelimi i Panelit.....	3
1.2. Instrumentet përkatëse të të drejtave të njeriut	5
1.3. Procedura dhe praktika	5
2. Paneli dhe Sekretariati	6
2.1. E përgjithshme	6
2.2. Anëtarët e panelit	7
2.3. Kryetari dhe anëtari zëvendësues.....	10
2.4. Sekretariati	10
3. Veprimtaritë e Panelit	11
3.1. Takimi me Grupin Punues të CivCom (Komiteti për Aspektin Civil për Menaxhimin e Krizave), Bruksel, Belgjikë	11
3.2. Fushata informuese	12
3.3. Uebfaqja.....	13
3.4. Rastet tek Paneli.....	13
3.5. Çështjet Administrative / Personelit	13
4. Pikëpamjet e jashtme dhe publikimet rreth Panelit.....	14
4.1. Mendimet e Komisionit të Venecias.....	14
4.2. Publikimi i OSBE-së rreth Mjeteve juridike dhe Asistencës për Anëtarët e Komunitetit	15
5. Përfundim.....	15
Shtojca 1 Lista e stafit.....	17
Shtojca 2 Tabela e Rasteve (31 dhjetor 2010)	17
Shtojca 3 Rregullorja E Punës	18
Shtojca 4 Mendimi i Komisionit të Venecias (pjesë e shkëputur).....	28

Parathënie:

Ky është raporti i parë vjetor i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (më tutje: Paneli) i cili përfshinë periudhën nga seanca përgatitore që ishte mbajtur nga java e parë e muajit maj 2010 deri më 31 dhjetor 2010.

Bashkimi Evropian ka themeluar Panelin më 29 tetor 2009, me mandat për të shqyrtuar shkeljet e supozuar të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të EULEX-i në Kosovë. Kjo e plotëson përgjegjësinë e përgjithshme të EULEX-it, ku përfshihen Njësia e Hetimeve të Brendshme të EULEX-it dhe Polica e Sigurimit të Përgjegjësishë ndaj Palës së Tretë.

Krijimi i Panelit ka lindur nga takimet, diskutimet dhe komentet midis organizatave ndërkombëtare, institucioneve dhe komunitetit ndërkombëtar gjatë viteve 2008 dhe 2009 që në fund ka çuar në formulimin e rekomandimeve për themelimin e mekanizmit llogaridhënës të të drejtave të njeriut për EULEX-in në Kosovë.

Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Gjinore ka luajtur rol kryesor në këto takime, diskutime dhe komentime rreth krijimit të Panelit në emër të Misionit të EULEX-it në Kosovë.

Ushtruesi i Shefit të Misionit të EULEX-it ka emëruar Anëtarët e Panelit dhe anëtarin zëvendësues, pas një konkursi të hapur më 4 maj 2010. Paneli miratoi Rregulloren e punës dhe u bë plotësisht operacional nga data 9 qershor 2010.

Që atëherë, veprimtaria kryesore e punës së Panelit është përqëndruar në përpunimin e numrit të lëndëve, në fushata për informim publik, rekrutimin e personelit ndërkombëtar dhe vendor të Sekretariatit, si dhe themelimin e zyrës, praktikave, procedurave dhe sistemeve të saj.

Paneli ka krijuar një status të pavarur dhe një identitet të veçantë nga EULEX-i në Kosovë, ndër të tjerash, përmes zbatimit të fuqishëm të fushatës informuese në Kosovë dhe Serbi, qasjes së saj pro-aktive, energjike për operacionet e saj të të drejtave të njeriut, si dhe ueb faqen e saj informuese, e cila mirëmbahet nga burimet e veta teknike dhe njerëzore.

Ky profil i pavarur i Panelit është përforcuar nga fakti se ajo ka Sekretariatin e vet që është në dispozicion gjatë gjithë kohës, dhe me zyre në qendër të Prishtinës e cila ofron qasje të lehtë për publikun dhe që është jashtëzakonisht, gjeografikisht dhe fizikisht ndaras nga ndërtesat apo funksionet e EULEX-it.

Edhe pse është ende në fillet e tij, Paneli është bërë pjesë përbërëse e strukturës së të drejtave të njeriut në Kosovë, ku tashmë Paneli ka dhënë një kontribut të

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

rëndësishëm në promovimin e llogaridhënies për shkeljet e të drejtave të njeriut si dhe krijimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Paneli vazhdon të shtojë vlera në mandatin më të gjerë të EULEX-it në Kosovë, pasi Paneli u ofron mjete juridike dhe asistencë të rëndësishme pjesëtarëve të gjerë të publikut që besojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.

Antonio Balsamo
Kryesues
Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Datë: 31 janar 2011

1. Hyrje

1.1. Themelimi i Panelit

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut është themeluar nga Bashkimi Evropian më 29 tetor 2009 me mandatin që të shqyrtojë shkeljet e supozuara të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.

Paneli është një organ llogaridhënës i pavarur, i jashtëm dhe transparent, i cili kryen funksionet e veta në mënyrë të paanshme dhe me ndershmëri. Ky Panel plotëson sistemin e përgjithshëm llogaridhënës të EULEX-it, ku përfshihen Njësia e Hetimeve të Brendshme të EULEX-it dhe Polisa e Sigurimit të Përgjegjesisë ndaj Palës së Tretë.

Në këtë raport janë të cekura informacione mbi veprimet dhe komentet e Bashkimit Evropian dhe komunitetit ndërkombëtar që i parapriu krijimi i Panelit. Këto përfshijnë referencat e Veprimit të Përbashkët 2008/124/CFSP⁵ të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i në Kosovë, e cila u miratua nga Këshilli i Evropës më 4 shkurt 2008.

Veprimi i Përbashkët, në themelimin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, ka dhënë Deklaratën e Misionit të EULEX-it, ndër të tjera, me një referencë për funksionet e veta ekzekutive si vijon:

*"EULEX në Kosovë do të ndihmojë institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur, shumë-etnik të drejtësisë dhe të forcës shumë-etnike të shërbimit policor dhe doganor, duke siguruar se këto institucione nuk kanë ndërhyrje politike dhe respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane. EULEX-i në Kosovë, në bashkëpunim të plotë me Programet Ndihmëse të Bashkimit Evropian, do ta përmbushë mandatin e tij përmes monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit, duke mbajtur disa funksione ekzekutive"*².

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit të EULEX-it, Veprimit të Përbashkët kanë përcaktuar, ndër të tjera, obligimin e saj për të siguruar se respektohen standardet e njohura ndërkombëtarisht sa i përket të drejtave të njeriut:

¹ Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 i ndryshuar nga Veprimi i Përbashkët i Këshillit 2009/445/CFSP i datës 9 qershor 2009.

² Id. Neni 2 (i).

³ Id. Neni 3 (i).

*"për të siguruar se të gjitha aktivitetet e saj respektojnë standardet ndërkombëtare sa i përket të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore"*³.

Para vendimit të Këshillit Evropian për krijimin e Panelit, Human Rights Watch, Amnesty International dhe Komiteti Norvegjez i Helsinkit kishte rekomanduar në një deklaratë të përbashkët për shtyp më 10 mars 2008 se misioni i propozuar i Bashkimit Evropian duhet t'i nënshtrohet një shkalle më të lartë të hetimeve dhe llogaridhënies sesa paraardhësi i tij, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, (UNMIK-u):

*"Nëse Bashkimi Evropian dëshiron të ndihmojë në ndërtimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit në Kosovë, ajo duhet të udhëheq me shembull. Kjo do të thotë se misioni e pranon shqyrtimin serioz të pavarur të dosjes së të drejtave të njeriut që nga dita e parë"*⁴.

Kjo ide u përforcua nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut të Këshillit Evropian gjatë misionit të tij special në Kosovë nga data 23-27 mars 2009, atëherë⁶ kur ai kërkoi që EULEX-i në Kosovë të krijoj një mekanizëm efektiv llogaridhënies si çështje e një rëndësi të lartë:

*"Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit, EULEX-i gjithashtu mund të shqyrtoj përparësitë e krijimit të një mekanizmi të pavarur llogaridhënies (për të drejtat e njeriut). EULEX-i e ka mundësinë të ushtrojë disa kompetenca ekzekutive, vetëm nëse ato nuk do të përdoren shumë shpesh. Ka një numër mundësish për mekanizmat llogaridhënës për EULEX-in. Një mundësi është se EULEX-i mund të marrë modelin e tanishëm të Panelin Këshillues për të Drejtat e Njeriut (UNMIK); një tjetër është që ankesat të mund të trajtohet nga Institucion i Ombudspersonit; mundësia e tretë është që EULEX-i të krijoj mekanizmin e vet të pavarur"*⁵

Rreth kësaj teme, Komisioneri ka shtjelluar në një njoftim për shtyp më 8 qershor 2009 si në vijim:

*"Askush, sidomos një organizatë ndërkombëtare, nuk është mbi ligjin ... kur organizatat ndërkombëtare ushtrojnë kontroll të ekzekutivit dhe legjislativit si një shtet surrogat ata duhet të jenë të detyruara nga të njëjtat kontrolle dhe balance, ashtu siç ne kërkojmë prej një qeverie demokratike"*⁶.

Më në fund, Bashkimi Evropian ka krijuar mekanizmin e vet të pavarur llogaridhënës për misionin e EULEX-it në Kosovë përmes themelimit të

⁴ Komunikatë e përbashkët për shtyp, Human Rights Watch, Amnesty International dhe Komiteti Norvegjez i Helsinkit, Bruksel, 10 mars 2008.

⁵ Raporti i Këshillit të Komisionerit Evropian për të Drejtat e Njeriut Misioni Special në Kosovë 23-27 mars 2009, paragrafi 80, gjendet gjithashtu edhe në uebfaqen e Komisionarit në: www.commissioner.coe.int.

⁶ Komunikatë për shtyp-450 (2009), 8 qershor 2009, Zyra e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut, gjenden gjithashtu edhe në uebfaqen e Komisionarit në: www.commissioner.coe.int.

Panelit më 29 tetor 2009. Zyrtarisht Paneli është emëruar nga Ushtruesi i Detyrës së Shefit të Misionit më 4 maj 2010. Paneli miratoj Rregulloren e vet të Punës dhe u bë operacional më 9 qershor 2010.

1.2. Instrumentet përkatëse të të drejtave të njeriut

Në përputhje me dispozitat e Konceptit për Llogaridhënie, Paneli mund t'i shqyrtoj ankesat sipas këtyre instrumenteve të të drejtave të njeriut:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNj), 1950)
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KEDR, 1965)
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP, 1966)
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK, 1966)
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDG, 1979)
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor, poshtërues ose degradues (KKT, 1984)
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijës (KNF, 1989)

Në praktikë, ankesat janë të bazuara kryesisht mbi nenet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) dhe Protokollet e saj përkatëse.

1.3. Procedura dhe praktika

Rregulloret e Punës përmban dispozita të hollësishme rreth trajtimit të ankesave, si dhe proceseve shqyrtuese të Panelit.⁷ Një përshkrim i shkurtër rreth hapave kryesorë të procedurës është dhënë më poshtë:

Ankuesi ose përfaqësuesi i tij ligjor mund të përfaqësohet para Panelit nga një avokat ose përfaqësues tjetër i zgjedhur prej tij.

Ankesa mund të paraqiten nga çdo person, përveç personelit të EULEX-it në Kosovë, i cili pretendon të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.

Ankesat duhet të dorëzohen në formë të shkruar dhe të nënshkruhet nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij dhe të paraqitet brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së pretenduar.

⁷ Rregullorja e punës është e bashkangjitur në këtë raport (shtojca 3).

Ankuesi duhet të bashkëngjës dëshmi dokumentuese, nëse ka, për të mbështetur ankesën, në veçanti, për të treguar se është plotësuar kriteri i pranueshmërisë.

Paneli njofton Shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë pas regjistrimit të secilës ankesë. Në këtë rast, i gjithë komunikimi midis Panelit dhe Misionit të EULEX-it në Kosovë kryhen përmes Zyrës për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Gjinore të EULEX-it në Kosovo.

Nëse Paneli mendon se ia vlen që rasti të hetohet, ajo fton Shefin e Misionit që të dorëzoj vërejtjet e tij me shkrim, duke iu përgjigjur pyetjeve të ngritura në mënyrë të hollësishme.

Pas pranimit të vërejtjeve nga Shefi i Misionit, Paneli mund të ftoj parashtruesin e ankesës të paraqes vërejtjet të tjera eventuale.

Kur palët të kenë pranuar të gjitha vërejtjet dhe paraqitjet me shkrim, Paneli vendos nëse ankesa është e pranueshme.

Komentet e Panelit kryesisht bazohen në parashtruesat me shkrim, mirëpo nëse konstaton se paraqitjet me shkrim të dorëzuara nga palët nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për tu konstatuar, atëherë Paneli mund të kërkoj prezantim me gojë.

Pas përfundimit të shqyrtimit të saj, Paneli prezanton gjetjet e tij, të cilat mund të përfshijnë rekomandime jo-detyruese për veprime korrigjuese dërguar Shefit të Misionit.

Shqyrtimi nga Paneli nuk mund të rezultojnë me ndonjë rekomandim që ankuesit t'i ofrohet kompensim monetar.

Vendimet dhe gjetjet i jepen parashtruesit të ankesës dhe Shefit të Misionit, dhe gjithashtu publikohen në faqen e internetit të Panelit në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

2. Paneli dhe Sekretariati

2.1. E përgjithshme

Paneli përbëhet nga dy ekspertë të jashtëm ndërkombëtar në ligjin e të drejtave të njeriut, si dhe një gjyqtar ndërkombëtar i brendshëm i EULEX-it. Procedura e konkursit për përzgjedhjen e anëtarëve të jashtëm, të tërhequr nga një listë e gjerë e kandidatëve nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendeve të tjera kontribuuese, është kryer përmes një procesi transparent dhe të ashpër të rekrutimit.

Kjo çoi në zgjedhjen dhe emërimin e kandidatëve të kalibrit më të lartë me përvojë të dëshmuar në të drejtat e njeriut, veçanërisht, në ligjin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Anëtari i tretë është një gjyqtar ndërkombëtar që shërben në Komponentin e drejtësisë në EULEX, në Kosovë, i cili ka njohuri rreth misionit të EULEX-it në Kosovë dhe rreth sistemit juridik të Kosovës. Ai është përzgjedhur edhe përmes një procesi konkurrues, pas një kërkesë për shprehje të interesit në mesin e gjyqtarëve ndërkombëtar të EULEX-it. Ai u propozua tek Shefi i Misionit për këtë emërim nga Shefi i Komponentit të Drejtësisë të EULEX-it në Kosovë, në konsultim me Kryetarin e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it.

Një anëtar zëvendësues, i cili është gjithashtu një gjyqtar ndërkombëtar që shërben në EULEX, u emërua me konkurs, për të zëvendësuar anëtarin e Panelit të EULEX-it, në rast se do të lindte ndonjë konflikt interesi në lidhje me përgjegjësitë e tij si Gjyqtar ndërkombëtar në Komponentin e Drejtësisë së EULEX-it.

2.2. Anëtarët e panelit

Ushtuesi i detyrës së Shefit të Misionit, EULEX-i në Kosovë zyrtarisht ka emëruar anëtarët e panelit dhe anëtarin zëvendësues më 4 maj 2010 si në vijim:

Z. Antonio Balsamo, shtetas italian, ka diplomuar për Drejtësi në Fakultetin e Jurisprudencës, Universiteti i Palermos në Itali në dhjetor 1986. Ai specializoi në të Drejtën e Pushtetit Rajonal dhe Lokal në Universitetin e Palermos në vitin 1991.

Ai punoi si gjykatës në Gjykatën e Palermos nga viti 1995-2007 ku u mor me shqyrtimin e shumë lëndëve të rëndësishme, përfshirë këtu edhe gjykimin e Giulio Andreotti lidhur me marrëdhëniet e ndërlikuara që ekzistonin mes krimit të organizuar dhe institucioneve publike. Z. Balsamo ishte kryesues i Gjykatës e cila urdhëroi konfiskimin e pasurive, që u vlerësuan qindra milionë euro, të Mafisë së Sicilisë në vitin 2002. Z. Balsamo është i punësuar në Gjykatën Supreme të Kasacionit në Itali që nga viti 2007, dhe është përgjegjës për trajnimin profesional të gjykatësve dhe prokurorëve të Gjykatës Supreme të Italisë. Ai është anëtar i Bordit Drejtues të Shoqatës së Gjykatësve të Italisë dhe drejtor i revistës “La Magistratura”. Ai gjithashtu është profesor i të drejtës penale në Shkollën për Specializime Pasuniversitare për profesionet juridike.

Z. Balsamo është ekspert gjyqësor i të drejtës evropiane, të drejtat e njeriut dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet kriminale. Ai ishte edhe anëtar i Këshillit Shkencor në Këshillin e Lartë Italian për Gjyqësi, i Komisionit për

Reformimin e Ligjit Penal të Italisë dhe anëtar i Komisionit Shkencor Rajonal të Institutit Ndërkombëtar për Studime të larta në Shkencat Penale. Ai gjithashtu mori pjesë si konsulent ekspert në projektet e Bashkimit Evropian që kishte të bënte me reformimin e ligjit penal të Bullgarisë si the themelimin e Zyrës së Prokurorit Publik për t'u përballë me krimin e organizuar dhe korrupsionin në IRJM dhe trafikimin me njerëz në Turqi.

Ai ka edituar librin “Giurisprudenza europea e processo penale italiano” (Jurisprudenca Evropiane dhe procesi penal italian) mbi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ndikimin e saj në ligjin e Italisë për procedurën penale. Ai gjithashtu ka botuar një libër mbi dëshmitë nga thashethemet si dhe disa artikuj në revistat e specializuara shkencore dhe kaptina librash mbi tema të ndryshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin shtetëror dhe ndërkombëtar.

Znj. Magda Mierzewska, shtetase polake, ka diplomuar në Universitetin e Gdanskut, në Poloni, dhe ka arritur shkallën magjistre e drejtësisë (LLM) në vitin 1980 dhe ka kaluar me sukses Provimin Shtetëror të Polonisë për postet gjyqësore në vitin 1982. Ajo u pranua në Odën e Këshilltarëve Juridik të Gdanskut në vitin 1989, ndërsa e ka fituar titullin LLM në të Drejtën e Bashkimit Evropian në Universitetin Leicester në vitin 2005.

Znj. Mierzewska ka punuar si mësimdhënëse në Fakultetin Juridik, Departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare, në Universitetin në Gdanskut nga viti 1982 deri në vitin 1991. Ajo u emërua Avokate në Sekretariatit e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg në vitin 1993. Pastaj, nga viti 1998 ajo ishte punësuar juriste në Sekretarinë e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, Francë.

Ajo ka një përvojë të gjatë në trajnimet ndërkombëtare për çështje të ndryshme thelbësore dhe procedurale për të drejtat e njeriut, kryesisht për avokatë, gjykatës, prokurorë dhe organizata joqeveritare.

Publikimet e shumta akademike të znj. Mierzewska përfshijnë: Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut: Dhjetë vite pas Ratifikimit, Zyra për Informim e Këshillit të Evropës në Varshavë, 2004; Pas dhjetë viteve: Popullariteti i Konventës në Poloni (bashkë-autor), Shqyrtimi i Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi i 4, 2004; Pas dhjetë viteve: Praktika gjyqësore polake voluminoze dhe interesante (bashkë-autor), Shqyrtimi i Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Botimi 5, 2004; Standardet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të KEDNj në Rastet lidhur me shpronësimet dhe aplikimin e tyre për kërkesat pronësore Gjermane, Instituti Polak për Marrëdhënie të Jashtme, 2005; Procesi i pranimi të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në Poloni dhe Sllovaki në: Pranimi i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të

Drejtave të Njeriut, eds. H. Keller, A. Stone-Sweet, Oxford University Press, maj 2008.

Z. Francesco Florit, shtetas Italian, ka diplomuar për Drejtësi në Universitetin e Triestes në vitin 1988 ku është dekoruar me vendin e parë për disertacionin e tij mbi të drejtën e tatimeve dhe të drejtën tregtare. Ai ka përfunduar një vit studime në Universitetin e Drejtësisë në Edinburg mbi Gjykatat Britanike, sistemin e të drejtës penale dhe sistemin e të drejtës zakonore në kuadër të Projektit për Juristët e Rinj Evropian në vitin 1998. Ai e kreu provimin e jurisprudencës më 1990 dhe punoi si avokat në sektorin e të drejtës së punës. Pas studimeve të mëtejshme dyvjeçare, ai e kaloi me sukses edhe provimin për t'u bërë gjykatës në vitin 1992.

Si gjykatës ai u mor me çështjet e të drejtës civile dhe penale për të specializuar më pas në të drejtën penale. Ai punoi si Gjykatës Ndërkombëtar me UNTAET në Timorin Lindor dhe në Panelin Special për Krime të Rënda prej vitit 2002 – 2005 ku i ka shqyrtuar rastet e krimeve të rënda kundër njerëzimit të kryera nga Armata Indoneziane. Ai është dërguar nga Qeveria e Italisë në Misionin për Sundimin e Ligjit EULEX (Komponenti I Drejtësisë) në mars 2008. Që nga fillimi i funksionimit më 9 dhjetor 2008 ai ka punuar si Gjykatës Ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë duke u marrë me rastet më të rënda të veprave penale.

Znj. Gabriele Gaube, shtetase gjermane, ka diplomuar për drejtësi në Universitetin Trier në Republikën Federale të Gjermanisë në vitin 1990. Pas përfundimit të studimeve pasuniversitare si dhe të provimit të dytë shtetëror, ajo fitoi titullin pasuniversitar në drejtësi në vitin 1993.

Atë vit ajo është emëruar Gjykatëse në Gjykatën Administrative në Berlin, ku ajo shërbeu deri në delegimin e saj në muajin mars të vitit 1999 në Ministrinë e Drejtësisë në Berlin, Departamenti për Arsimit dhe Aftësim/Bordi për Shqyrtimin e Ligjeve. Pas delegimit të saj në muajin janar të vitit 2003 ajo u emërua Kryegjykatës i Gjykatës Administrative dhe në muajin dhjetor të vitit 2004 Gjykatëse e Gjykatës së Lartë Administrative. Në muajin janar 2005, ajo u rikthye në detyrën e saj në Gjykatën e Lartë Administrative në Berlin-Brandenburg (gjykata e apelit dhe gjykata e shkallës së fundit lidhur me legjislacionin e shteteve federale të Berlinit dhe Brandenburgut) ku, në muajin janar të vitit 2007, ajo u emërua zëvendës Kryegjykatës.

Nga muaji nëntor 2008, ajo ka qenë në një puShM të jashtëzakonshëm nga Gjykata e Lartë Administrative dhe është dërguar nga Republika Federale e Gjermanisë në misionin e EULEX-it në Kosovë. Atje, ajo u emërua gjykatëse ndërkombëtare në Panelin e Apeleve në Gjykatën Supreme për rastet e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe Gjykatës për Apele për Ankesat drejtuar Agjencisë Kosovare të Pronës, respektivisht nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe shefi i misionit të EULEX-it në Kosovë në muajin janar

2009. Në muajin prill 2010, nga ajo është kërkuar që të mbulojë edhe proceset civile në përgjithësi si dhe proceset penale duke ju referuar kështu kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

2.3. Kryetari dhe anëtari zëvendësues

Në seancën konstituive të mbajtur më 6 maj 2010 Paneli ka zgjedhur kryetar z. Antonio Balsamon, dhe pas miratimit të Rregullores së punës më 9 qershor 2010 Paneli u bë plotësisht operacional.

Znj. Gaube, anëtare zëvendësuese e Panelit, ka përfunduar detyrën e saj si gjyqtare e EULEX-it më 31 dhjetor 2010 dhe procedura e përzgjedhjes së zëvendësimit të anëtares zëvendësuese nisi në nëntor 2010.

2.4. Sekretariati

Sekretariati i Panelit përbëhet nga një Zyrtar i Lartë Ligjor, një Zyrtare Ligjore, një Asistente Administrative/Gjuhësore dhe dy Përkthyes. Procesi i rekrutimit të një Zyrtari Ligjor është në vazhdim e sipër

Z. John J. Ryan, shtetas irlandez, ka disponuar për Drejtësi si Bachelor, (Hons) në Drejtësi dhe Studime Evropiane nga Universiteti i Limerick, Irlandë, dhe ai mban diplomë pasuniversitare si avokat nga Asociioni i Avokatëve të Irlandës. Ai ka punuar si avokat me Stephen MacKenzie dhe Co Solicitors, në Dublin, Irlandë. Ai ka shërbyer në misionet paqeruajtëse me Kombet e Bashkuara në Liban, Siri, Izrael, Kamboxhia, Bosnja Hercegovinë, Maqedoni, Timor Lindor, Nepal dhe në Kosovë. Para se të marrë përgjegjësitë e tij të tanishme ai ishte i punësuar në UNMIK, ndër të tjera, si Administrator në Komunën e Zveçanit, Regjioni i Mitrovicës, Shef i Divizionit për Mbështetje Gjyqësore Ndërkombëtare, Departamenti i Drejtësisë, ushtrues i detyrës së Këshilltarit Ligjor, ZPVKB (Zyra e Përfaqësuesit të Veçantë të Kombeve të Bashkuara), dhe Zyrtar Ekzekutiv, Paneli Këshillëdhënës i të Drejtave të Njeriut. Ai është Zyrtar i lartë Ligjor dhe shef i Sekretariatit të Panelit që nga muaji prill 2010.

Znj. Leena Leikas, me shtetësi finlandeze, ka diplomuar në shkallën e Magjistrisë të Drejtësisë nga Universiteti Turku, në Finlandë dhe pastaj u kualifikuar si gjyqtare. Pas dy vjet e gjysmë në Departamentin e Hartimit të Ligjeve, në Ministrinë e Drejtësisë, ajo është punësuar nga Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa në Departamentin Ligjor, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku ajo u specializua në çështjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Nga nëntori i vitit 2007 e deri në prill 2010 ajo ka punuar si avokate për përpunimin e lëndëve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në

Strasbourg, Francë. Ajo është Zyrtare Ligjor në Sekretariatit e Panelit që nga maji 2010.

Znj. Shpresa Gosalci, shqiptare e Kosovës, ka diplomuar në Universitetin AAB, Prishtinë, në degën e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze. Ajo ishte punësuar si përkthyes (shqip / serbisht / anglisht) në KFOR nga korriku 1999 deri në qershor 2000, si dhe Asistente Administrative/Gjuhësore në Zyrën e Informimit Publik dhe Media e Komisionerit të Policisë së UNMIK-ut nga qershori 2000 deri në mars 2009. Ajo është Asistente Administrative/Gjuhësore në Sekretariatit e Panelit që nga korriku 2010.

Znj. Katica Kovaçević, serbe e Kosovës, ka qenë e punësuar më parë si Asistente Administrative/Gjuhësore (serbisht / anglisht) në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm nga maji 2003 deri në dhjetor 2008 dhe si Asistente Gjuhësore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nga janari 2009 deri në nëntor 2010. Ajo filloj punën si përkthyes në Sekretariatit e Panelit në dhjetor 2010.

Z. Kushtrim Xhaferi, shqiptar i Kosovës, ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës, Kosovë, në degën e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze. Ai më parë ka punuar si përkthyes (shqip / anglisht) në Korporatën Energjetike të Kosovës nga shkurti 2004 deri në janar 2009, dhe më pas si Asistent gjuhësor në Komponentin e Policisë së EULEX-it. Ai punon si Përkthyes në Sekretariatit nga shtatori 2010.

3. Veprimtaritë e Panelit

3.1. Takimi me Grupin Punues të CivCom (Komiteti për Aspektin Civil për Menaxhimin e Krizave), Bruksel, Belgjikë

Paneli është ftuar të takohej me Delegacionin e Grupit Punues të CivCom (Komiteti për Aspektin Civil për Menaxhimin e Krizave) nën patronazhin e Presidencën së Spanjës në Bruksel më 7 qershor 2010. Kryesuesi i Panelit ka njoftuar anëtarët e Panelit me Grupin Punues dhe i ka njoftuar ata rreth mandatit dhe veprimtarive operacionale deri aty. Ai gjithashtu i ka njoftuar ata rreth statusit të propozim Rregullores së Punës dhe paraqiti propozim-planin e veprimt për fushatën e informimit.

Më pas, përfaqësuesit e Grupit Punues iu drejtuan Panelit, kurse janë ngritur këto pika parimore si në vijim: Rëndësia e një fushate të plotë ndërgjegjësimit për publik, në mënyrë që të sqarohet mandati dhe roli i Panelit, duke përfshirë kufizimet e saj; zhvillimin e bashkëpunimit të fortë me OJQ-të që merren me të drejtat e njeriut, dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile; krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira të punës me media; qartësimi i ligjit të zbatueshëm për

të drejtat e njeriut dhe zhvillimi dhe promovimi i një kulture të të drejtave të njeriut në Kosovë.

3.2. Fushata informuese

Paneli ka filluar një fushatë informuese gjithëpërfshirëse për të rritur ndërgjegjësimin e publikut të gjerë rreth mandatit dhe funksioneve të saja në maj 2010. Deri më tani, në këtë fushatë ka pasur takime të shumta me OJQ-të, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesve në Prishtinë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, në Mitrovicën jugore dhe veriore, si dhe në komunën e Ferizajt dhe Skenderajt.

Në fushatë gjithashtu ka asur takime që janë mbajtur në nivelin qendror qeveritar me Ministrin e Drejtësisë dhe me zyrtarë qeveritarë / të administratës në nivelin rajonal dhe komunal.

Gjithashtu janë mbajtur takime edhe me përfaqësues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Këshillin e Evropës (CoE), Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OUNHCHR), Zyrën Civile Ndërkombëtare (ICO), Zyrën e Përfaqësuesit Special të BE-së (PSBE) dhe NATO-s / KFOR-in, si dhe Ombudspersonin e Kosovës, me qëllim që t'i njoftuar ata rreth mandatit, ekzistencës dhe funksionet e Panelit, si dhe për të marrë mbështetje dhe ndihmë nga ta në fushatën e ndërgjegjësimit të publikut.

Paneli përveç kësaj ka mbajtur intervista me TV, radio, reporterë të gazetave që kanë transmetuar intervista dhe kanë botuar artikuj rreth Panelit. Në fushatë është përfshirë edhe shpërndarjen e broshurave informative dhe posterave si dhe organizimi i një seminari për të drejtat e njeriut për OJQ-të dhe për të tjera aspekte të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në bashkëpunim me Qendrën Juridike të Kosovës.

Me rëndësi për tu përmendur, me një situatë të përmirësuar të sigurisë, Paneli me sukses ka filluar fushatën e vet informuese në pjesën veriore të Mitrovicës më 11 nëntor 2010 dhe është planifikuar të fillojë fushatën e vet në Serbi në javën e tretë të janarit, 2011.

Të gjithë ata të cilët Paneli ka bashkëvepruar, në veçanti OJQ-të, janë përgjigjur në një mënyrë shumë pozitive dhe ka marrë pjesë me entuziazëm në takimet e fushatës informuese, ngjarje dhe seminare. Një marrëdhënie e shkëlqyer puna është zhvilluar në mes Panel dhe homologëve të tij në të gjitha nivelet në këtë fushatë dhe deri më sot fushata informative ka qenë shumë e suksesshëm.

Sekretariati ka zhvilluar një plan gjithëpërfshirës të veprimit për fushatën e vet

informuese për tërë vitin 2011. Ky plan përfshinë programin për fillim e fushatës informuese në Serbi gjatë javës së tretë të janarit 2011.

3.3. Uebfaqja

Sekretariati ka projektuar, zhvilluar dhe tani mirëmban faqen e vet në: www.hrrp.eu. Faqja përmban informacione të dobishme mbi mandatin, funksionet, veprimtaritë dhe veprimet e Panelit, si dhe komunikata për shtyp, statusin e tanishëm të rasteve në pritje dhe rasteve të përfunduara. Ajo gjithashtu mban informacione mbi ligjin e zbatueshëm të të drejtave të njeriut, si dhe formularët për ankesë dhe udhëzimet për paraqitjen e ankesës në gjuhët angleze, shqipe dhe serbe.

3.4. Rastet tek Paneli

Gjatë shtatë muajve të parë të funksionimit të saj, Paneli ka pranuar 16 ankesa. Pas shqyrtimit, gjatë ankesa janë konsideruar të papranueshme, pasi nuk kanë hyrë në kuadër të mandatit të Panelit.

Dy raste janë komunikuar tek Shefi i Misionit për vëreje, dhe janë kërkuar informata shtesë nga Shefi i Misionit për pesë raste para vazhdimit të procedimit të mëtutjeshme të tyre.

Ankesat që janë parashtruar deri më tani në Panel lidhen kryesisht me Nenin 2 të: E drejta për të Jetuar, Neni 6 E Drejta për Gjykim të Drejtë brenda një afat të arsyeshëm dhe Protokollin 1, Neni 1 Mbrojtja e Pronës së Ligjit të Konventës Evropiane rreth të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Themelore.

3.5. Çështjet Administrative / Personelit

Ka mungesë të madhe të pozitive të punës të kontraktuara për dallim nga pozitat e punës të dërguara në EULEX, të cilat kanë paraqitur vështirësi për Panelin gjatë procesit të tanishëm të rekrutimit të një zyrtari tjetër ligjor.

Është e domosdoshme që të rekrutohen zyrtarë ligjor që janë kualifikuar për të siguruar që Paneli të operoj me kapacitetin më të lartë dhe për këtë qëllim sigurimi i pozitës ligjore të kontraktuar është i domosdoshëm.

Paneli nuk ka buxhet të dedikuar dhe në këtë drejtim është tërësisht i varur nga sistemi buxhetor i EULEX-it. Megjithatë, kryesisht si rezultat i mbështetjes së vazhdueshme nga EULEX-i, Paneli shumë shpejt u bë operacional, shumë shpejtë filloj me shqyrtimin e rasteve dhe u bë në gjendje të merrte vendimet e para të papranueshmërisë menjëherë pasi Paneli u bë operacional.

Edhe pse Paneli është plotësisht i kënaqur me mbështetjet buxhetore dhe kategoritë e tjera të ofruara aq bujarisht nga EULEX-i; do të kishte mjaft dobi, por do ta zgjeronte edhe më tej pavarësinë e Panelit nëse Paneli do ta kishte buxhetin e vet.

Megjithatë, Paneli do të donte të shprehte vlerësimin e tij të sinqertë sa i përket bashkëpunimit të shkëlqyeshëm, mbështetjes administrative dhe ndihmën profesionale që ka marrë nga EULEX-it në Kosovë gjatë gjithë kohës dhe në veçanti nga Zyra për Drejtat e Njeriut dhe Çështje Gjinore, e cila është kanal përmes së cilës Paneli komunikon dhe ndërvepron në mënyrë efektive me EULEX-in në Kosovë.

4. Pikëpamjet e jashtme dhe publikimet rreth Panelit

4.1. Mendimet e Komisionit të Venecias

Në vitin 2004 në lidhje me mandatin e UNMIK-ut, Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) në Mendimin e vet ka dhënë vërejtjet e tij rreth përgjegjësisë së organizatës ndërkombëtare, standareve të të drejtave të njeriut, ushtrimit të mandatit ekzekutiv, si në vijim:

“kur një organizatë ndërkombëtare mban funksione ekzekutive që janë të ngjashme me ato të një shteti, ajo nuk duhet që të jetë e përjashtuar prej çfarë shqyrtimi të pavarur ligjor, prej një sistemi të pavarur shqyrtues në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut”.

Komisioni i Venecias ka miratuar një Mendim rreth Mekanizmave Ekzistues për të Shqyrtuar pajtueshmërinë me Standardet e Akteve për të Drejtat e Njeriut nga UNMIK-u dhe EULEX-i në Kosovë tash së fundi më 21 dhjetor 2010⁸. Një pjesë e shkëputur e Mendimit është e bashkangjitur si Shtojcë në këtë raport.

Komisioni i Venecias, në Mendimin e tij ka deklaruar se një kontribut nga jashtë për procedurën e emërimit të anëtarëve të Panelit është e domosdoshme dhe se dy anëtarë të jashtëm duhet të emërohen nga Shefi i Misionit duke u këshilluar me Kryetarin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Komisioni gjithashtu ka vënë re se *“një shqyrtim nga Paneli nuk mund të çoj në rekomandime për kompensim ... (Komisioni) është i mendimit se, në parim, restitutio in integrum (rikthim në gjendjen fillestare) është mënyra më e përshtatshme për të korrigjuar shkeljet e të drejtave të njeriut ... në disa raste kompensimi më efikas është kompensimi financiar, të cilin Paneli nuk mund ta rekomandoj”.*

⁸ Mendimi nr. 545 / 2009 i datës 20 dhjetor 2010 (CDL-AD(2010)051)
[www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD\(2010\)051-e.pdf](http://www.venice.coe.int/docs/2010/CDL-AD(2010)051-e.pdf)

Sidoqoftë, Komisioni mendon se në raste të tilla do të ishte e mundur që parashtruesi i ankesës të kërkonte kompensim në të holla, së paku, për dëmin material, në Policën e Sigurimit të Përgjegjësisë ndaj Palës së Tretë.

Komisioni i Venecias ka përgëzuar faktin se Paneli është bërë operacional dhe ka vënë re se ajo veç kishte filluar shqyrtimin e ankesave disa javë pas themelimit të saj.

Më tej, ajo ka vënë re se Paneli ishte duke zbatuar një fushatë informuese gjithëpërfshirëse dhe vendimet e saj sakaq janë publikuar në uebfaqen e Panelit në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Komisioni më tutje ka thënë se ishte *“e mendimit se një qasje e tillë efektive dhe proaktive meriton që të përshëndetet dhe të përkrahet”*.

4.2. Publikimi i OSBE-së rreth Mjeteve juridike dhe Asistencës për Anëtarët e Komunitetit

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) së fundi ka publikuar një katalog të titulluar “Ushtroni të drejtat e juaja! Mjetet juridike dhe Asistencë për Anëtarët e Komunitetit”⁹. Qëllimi i këtij katalogu është që të ju sigurojë, si anëtar i komunitetit në Kosovë, informacione mbi atë se çfarë duhet bërë në rast se keni ndonjë ankesë lidhur me respektimin e të drejtave tuaja themelore.

Katalogu është i organizuar në mënyrë tematike, me pjesë që mbulojnë, ndër të tjera, çështjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtat gjinore, kthimin e personave të zhvendosur, çështjen e sigurisë publike dhe çështjet pronësore.

Çdo organ dhe institucion individual, përfshirë Panelin për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, është në një renditje të veçantë, dhe se katalogu përshkruan shkurtimisht qëllimin e organeve apo institucioneve, pasuar me shembuj të situatave të cilat mund të ndihmojnë një person të dëmtuar. Rënditjet përfshijnë udhëzime të veçanta rreth qasjes informatës për kontakt, dhe se si të parashtrohet një ankesë.

5. Përfundim

Tashmë Paneli është themeluar brenda strukturës organizative të Bashkimit Evropian si një mekanizëm efektiv për mbrojtjen dhe promovimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të funksionit

⁹ <http://www.osce.org/kosovo/73421>

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

ekzekutiv të Bashkimit Evropian në Misionet për Siguri të Përbashkët dhe Politikë të Mbrojtjes.

Kështu, ky shërben si mjet për të siguruar përgjegjësinë e Bashkimit Evropian për shkeljet e Konventës Evropiane në të Drejtat e Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të funksionit ekzekutiv në Kosovë.

Si i tillë, Paneli përbën një model potencial, si një mekanizëm llogaridhënës për të drejtat e njeriut për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut kur Bashkimi Evropian ushtron funksion ekzekutiv në Misionet e ardhshme të Sigurisë së Përbashkët dhe Politikës së Mbrojtjes.

për informata të tjera rreth Panelit shih www.hrrp.eu.

Shtojca 1 Lista e stafit

Paneli	
Antonio Balsamo	Kryesues i Panelit
Magda Mierzevska	Anëtare e Panelit
Francesco Florit	Anëtar e Panelit
Gabriele Gaube	Anëtare zëvendësuese e Panelit deri më 31 dhjetor 2010
Sekretariati	
John J. Ryan	Zyrtar i lartë ligjor
Leena Leikas	Zyrtare ligjor
Shpresa Gosalci	Asistente Administrative / Gjuhësore (Shqip-Anglisht)
Katica Kovacevic	Përkthyes (Serbisht-Anglisht)
Kushtrim Xhaferi	Përkthyes (Shqip-Anglisht)

Shtojca 2 Tabela e Rasteve (31 dhjetor 2010)

Në pritje	10
Të papranueshme	6
Shkelje	0
Nuk ka shkelje	0
Gjithsej të regjistruar	16

Shtojca 3 Rregullorja E Punës

Kapitulli 1. Dispozitat e përgjithshme

Rregulla 1. Qëllimi i Rregullores së Punës

Rregullorja e punës ka për qëllim vendosjen e rregullave të cilat do të zbatohen nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (PShDNj) dhe të rregullave të cilat paraqiten para tij në procedurat të cilat përfshihen me Koncept Dokumentin mbi Llogaridhënien, i datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit Shqyrtues për të Drejtat e Njeriut.

Rregulla 2. Definicionet

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, vetëm nëse konteksti kërkon ndryshe, kuptimi i termave të mëposhtëm është si vijon:

- a. "Veprim i Përbashkët" do të thotë Veprimi i Përbashkët i Këshillit të Bashkimit Evropian nr. 2008/124/PPJS, i datës 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX, Kosovë;
- b. "Panel" do të thotë Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut;
- c. "Ankues" do të thotë çdo person, përveç personelit të EULEX-it, që ka parashtruar një ankesë dhe që pretendon të ketë qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë përmbushjes së mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë;
- d. "Përfaqësues" do të thotë person i cili përfaqëson një ankues në procedimet para Panelit;
- e. "ShM" do të thotë Shefi i Misionit të EULEX-it.

Kapitulli 2. Organizimi i Panelit

Rregulla 3. Anëtarët e Panelit

Paneli do të përbëhet prej anëtarëve ndërkombëtarë. Ai do të jetë i pavarur gjatë ushtrimit të funksioneve të veta.

Paneli do të përbëhet prej tre anëtarëve, prej të cilëve njëri do të jetë gjykatës i EULEX-it. Gjykatësi i EULEX-it do të emërojë një zëvendës.

Anëtarët e Panelit do t'i shërbejnë Panelit në mënyrë që ai të kryej funksionet e veta në mënyrë të paanshme dhe me ndershmëri.

Rregulla 4. Procedura e përzgjedhjes dhe emërimit

Dy anëtarë të Panelit, përveç gjykatësit të EULEX-it, do të përzgjidhen përmes konkursit.

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Anëtarët e Panelit do të emërohen nga ShM për një afat kohor prej jo më pak se një vit. Për rastin e gjykatësit të EULEX-it dhe zëvendësuesin e tij/saj, ShM emëron anëtarin e Panelit pas konsultimeve të kryera me Shefin e Komponentit të Drejtësisë. Shefi i Komponentit të Drejtësisë jep mendimin e vet pas konsultimeve të kryera me Kryetarin e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it.

Rregulla 5. Dorëheqja

Dorëheqja e një anëtari të Panelit, ose zëvendësuesi të gjykatësit të EULEX-it njoftohet tek Kryetari i Panelit, i cili do ta përcjell atë tek ShM.

Rregulla 6. Zgjedhja e Kryetarit

Anëtarët e Panelit do të zgjedhin njërin prej anëtarëve për Kryetar të Panelit. Gjatë procedurës së zgjedhjes së kryetarit mund të merr pjesë edhe anëtari zëvendësues. Në rast të barazimit, votimi përsëritet, duke përjashtuar anëtarin zëvendësues. Për kryetar nuk mund të caktohet gjykatësi i EULEX-it, e as zëvendësuesi i tij/saj. Mandati i kryetarit është për një vit, me mundësi të rizgjedhjes.

Rregulla 7. Funkcionet e Kryetarit

Kryetari drejton punën e Panelit.

Rregulla 8. Zëvendësimi i Kryetarit

Nëse Kryetari nuk është në gjendje të kryej detyrat e tij/ saj, apo nëse posti i Kryetarit është i lirë, detyrën e Kryetarit e kryen një anëtar tjetër që nuk është gjykatës i EULEX-it.

Rregulla 9. Mbështetja nga Sekretariati

1. Mbështetja e Panelit nga Sekretariati sigurohet përmes Zyrtarit të Lartë Ligjor dhe stafit të Sekretariatit.

2. Zyrtari i Lartë Ligjor, nën udhëzimin e Panelit do të jetë përgjegjës posaçërisht për:

- a. Të asistojë Panelin dhe anëtarët e tij në përmbushjen e detyrave të tyre;
- b. Të jetë kanal për të gjitha komunikimet lidhur me Panelin;
- c. Të mbikëqyrë arkivat e Panelit;

Kapitulli 3. Funkcionimi i Panelit

Rregulla 10. Selia e Panelit

1. Selia e Panelit do të jetë në Prishtinë.

2. Paneli mund të vendosë të kryej funksionet e veta diku tjetër në Kosovë, nëse e konsideron të përshtatshme.

Rregulla 11. Seancat e Panelit

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

1. Paneli do të mbajë seancat e tij të rregullta në çdo dy muaj. Caktimi i seancave të jashtëzakonshme varet nga Paneli.

2. Anëtarët të cilët janë të penguar prej ndonjë sëmundje apo arsye tjetër serioze që të marrin pjesë në një seancë të plotë të Panelit ose në një pjesë të saj apo nga përmbushja e ndonjë detyre tjetër të Panelit, duhet sa më shpejt që është e mundur të informojnë për këtë Kryetarin.

Rregulla 12. Tërheqja

1. Një anëtar i Panelit mund të mos merr pjesë në punimet e Panelit për shqyrtimin e ndonjë lënde, në rast se:

1. Ai ose ajo është në pozitë të konfliktit të interesit;
2. Ai ose ajo ka shprehur publikisht mendimin e tij/saj, nëpërmes medieeve, me shkrim, nëpërmes veprimeve të tij/saj publike, të cilat objektivisht mund të ndikojnë në mënyrë jo të favorshme në paanshmërinë e tij/saj;
3. Për ndonjë arsye tjetër, pavarësia dhe paanshmëria e tij/saj legjitimisht mund të vihet në dyshim për ndonjë arsye.

2. Në rast të ndonjë dyshimi lidhur me ekzistimin e njëres prej arsyeve të përmendura në paragrafin 1, ajo çështje do të vendoset nga Paneli pa pjesëmarrjen e anëtarit përkatës.

Rregulla 13. Shqyrtimet

1. Paneli do të kryej shqyrtimet me dyer të mbyllura dhe shqyrtimet e tij do të mbesin të fshehta. Vetëm Zyrtari i Lartë Ligjor dhe anëtarët e Sekretariatit, përkthyesit dhe personat të cilët ofrojnë ndihmë tjetër për Panelin mund të marrin pjesë në këto takime, përveç nëse Paneli vendos ndryshe.

2. Procesverbal i shqyrtimit mbahet, *mes tjerash*, duke regjistruar emrat dhe funksionet e personave të pranishëm gjatë shqyrtimit.

3. Aty ku është e nevojshme që Paneli të vendosë për një pikë të procedurës që është jashtë seancës së caktuar të Panelit, Kryetari mund të udhëzojë që shqyrtimi të mbahet me prani të mjeteve elektronike.

Rregulla 14. Kuorumi

1. Paneli mund të vendos vetëm nëse janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij apo, në rast të Rregullës 13, paragrafi 3, nëse të gjithë anëtarët e tij marrin pjesë në shqyrtim përmes mjeteve elektronike, me përjashtim të dispozitës nga paragrafi 3.

2. Në rast të dorëheqjes apo tërheqjes së anëtarit, i cili/cila është gjykatës i EULEX-it, apo nëse mungesa e tij/saj sipas Rregullës 11, paragrafi 2, ai/ajo përkohësisht do të zëvendësohet nga personi zëvendësues.

3. Në rast të dorëheqjes apo tërheqjes së një anëtari, me përjashtim të gjykatësit të EULEX-it, apo mungesës së tij/saj sipas Rregullës 11, paragrafi 2, Paneli mund të

vendos me dy anëtarë të cilët janë të pranishëm apo marrin pjesë në shqyrtim përmes mjeteve elektronike. Në rast të barazimit, anëtari i cili/cila nuk është gjykatës i EULEX-it do të jep votën përfundimtare.

Rregulla 15. Votimi

Vendimet e Panelit merren nga shumica e anëtarëve të cilët marrin pjesë në votim. Abstenimet nuk lejohen.

Kapitulli 4. Procedura

A. Rregullat e Përgjithshme

Rregulla 16. Gjuhët

1. Gjuhët zyrtare të Panelit janë gjuha shqipe, serbe dhe angleze.
2. Versioni autentik i vendimit do të jetë në gjuhën angleze. Versioni në gjuhën angleze do të përkthehet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.
3. Në rast të konfliktit apo të mospërputhjeve ndërmjet versionit të dokumentit në gjuhën angleze ose të vendimit dhe versioneve të tij në gjuhën shqipe dhe serbe, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Rregulla 17. Përfaqësimi i ankuesve

Ankuesit dhe, siç mund të ndodhë, përfaqësuesit e tyre të ligjshëm, mund të përfaqësohen para Panelit nga avokatët e tyre apo nga përfaqësues të tjerë sipas zgjedhjes së tyre.

Rregulla 18. Përfaqësimi i Shefit të Misionit

ShM mund t'i paraqes Panelit parashtresë me shkrim ose një paraqitje me gojë apo të autorizojë një anëtar të Misionit për këtë qëllim.

Rregulla 19. Veprimi në raste specifike

1. Paneli mundet, me propozim të tij ose me kërkesë të ankuesit apo të Shefit të Misionit, të merr çdo veprim të cilin e konsideron të përshtatshëm apo të nevojshëm për kryerjen e drejtë të detyrave të veta.
2. Paneli mund të kërkoj nga një apo më shumë anëtarë të tij të ndërmerr një veprim të tillë në emërin e tij, dhe veçanërisht të dëgjojë ekspertë apo persona të tjerë, që të ekzaminojë dokumente apo të vizitojë ndonjë lokacion. Ky anëtar apo anëtarë duhet t'i raportojnë Panelit për rezultatet e veprimeve që janë ndërmarrë.

Rregulla 20. Bashkimi i ankesave

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Paneli mundet, nëse konsideron se është në interes të zhvillimit të duhur të procedimit, të urdhërojë bashkimin e një apo më shumë ankesave.

Rregulla 21. Urdhri i procedimit të ankesave

1. Paneli do të merret me ankesa sipas rendit kur ato janë bërë të gatshme për ekzaminim.
2. Paneli mund të vendosë për t'i dhënë prioritet një ankese të veçantë.

Rregulla 22. Masat e përkohshme

1. Paneli apo, ku është e përshtatshme kryetari, mundet, me kërkesë të ankuesit, apo me propozimin e vet t'i propozojë SHM ndonjë masë të përkohshme për të cilën konsideron se duhet miratuar në interes të zhvillimit të duhur të procedimeve para tyre. SHM duhet të merr një vendim.
2. Paneli mund të kërkojë informatë nga ankuesi apo nga personat e tjerë për çfarëdo çështje në lidhje me zbatimin e ndonjë mase të përkohshme të vendosur nga ShM.

Rregulla 23. Afati kohor

Afati kohor për informacion, vështrime apo komente të kërkuara nga ankuesi dhe ShM caktohen nga Paneli.

Rregulla 24. Shpenzimet

Nuk parashihet ndonjë pagesë për parashtrim ose procedim të një ankese.

B. Ankesat

Rregulla 25. Parashtrimi i ankesës

1. Çdo person mund të parashtrorë ankesë, përveç personelit të EULEX-it në Kosovë, i cili/cila deklaron se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë përmbushjes së mandatit ekzekutiv të tij. Paneli nuk do të merret me shqyrtimin e seancave gjyqësore të gjykatave të Kosovës.
2. Paneli do të ekzaminojë vetëm ankesat lidhur me deklarinimin e shkeljes së të drejtave të njeriut të cilat kanë ndodhur pas datës 9 dhjetor 2008 në Kosovë.
3. Ankesa duhet t'i dorëzohet Panelit brenda tre muajve nga data kur Paneli mund të pranojë ankesat, apo brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së deklaruar, cilado që është e përshtatshme për ankuesin.
4. Ankesa duhet të parashtrorë me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga ankuesi.
5. Aty ku ankuesi përfaqësohet në pajtim me dispozitat nga Rregulla 17, një autorizim me shkrim i cili vërteton përfaqësimin e ankuesit duhet t'i paraqitet Panelit nga përfaqësuesi i tij/saj.

Rregulla 26. Përmbajtja e ankesës

1. Ankesa duhet të përmbajë:

1. Identitetin e ankuesit, duke përfshirë siç duhet: emrin, datën e lindjes, profesionin dhe adresën e personit në fjalë;
2. Emrin, profesionin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse ka;
3. Një deklaratë mbi të gjitha faktet përkatëse;
4. Një deklaratë përmbledhëse të shkeljeve të deklaruara të instrumenteve përkatëse për të drejtat e njeriut.

2. Ankuesi duhet të bashkëngjis çdo dëshmi dokumentuese, nëse ka, për të mbështetur ankesën, në veçanti për të treguar se kriteret e pranueshmërisë së saj janë përmbushur.

3. Ankuesi mund të përdor një format standard të ankesës e cila sigurohet nga Paneli.

Rregulla 27. Regjistrimi i ankesave dhe informacioni për Shefin e Misionit

1. Zyrtari i Lartë Ligjor do të mbajë një regjistër të ankesave, në të cilin do të shënohet, *mes tjerash*, data e regjistrimit të ankesës dhe data e përfundimit të procedimeve.

2. Pas regjistrimit të ankesës informohet Shefi i misionit.

Rregulla 28. Emërimi i raportuesit

1. Kryetari duhet të emërojë një anëtar të Panelit si raportues, i cili/cila do të ekzaminojë ankesën.

2. Gjatë ekzaminimit të ankesës raportuesi:

1. Mund të kërkojë nga Ankuesi dhe Shefi i Misionit që të dorëzojnë, brenda një afati kohor të caktuar, informacion faktik, dokumente dhe materiale të tjera, të cilat mund të konsiderohen si të rëndësishme;
2. Dorëzon raporte të tilla, drafte dhe dokumente tjera, të cilat mund t'i ndihmojnë Panelit në kryerjen e funksioneve të veta.

C. Shqyrtimi i ankesës

Rregulla 29. Vendimi mbi papranueshmërinë pa komunikimin e ankesës tek Shefi i Misionit

1. Paneli mund ta shpall ankesën të papranueshme gjatë procedimit përmbledhës nëse:
 - a. Për nga përmbajtja është e njëjtë me një çështje e cila është shqyrtuar nga Paneli dhe e cila nuk përmban ndonjë informacion shtesë të rëndësishme;
 - b. Është anonime;
 - c. Është paraqitur pas afateve kohore të paraqitura në Rregullën 25, paragrafi 3;
 - d. Është e pabazuar;
 - e. Është shpërdorim i të drejtës së Ankuesit.

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

2. Vendimi i Panelit për papranueshmërinë do të përmbajë një përshkrim të shkurtër të fakteve të lëndës sikurse edhe arsyet e vendimit të tij. Paneli po ashtu do të deklarohet nëse vendimi është marrë njëzëri apo me shumicë votash. Rregulla 35 do të zbatohet *mutatis mutandis*.

Rregulla 30. Komunikimi i ankesës tek Shefi i Misionit. Procedimet me shkrim

1. Nëse procedura sipas Rregullës 29 nuk është e zbatueshme, Paneli mund të vendos të ekzaminojë pranueshmërinë dhe meritën njëkohësisht, ose ndaras.

2. Sidoqoftë, Paneli do ta informojë ShM për ankesën, duke e ftuar EULEX-in në Kosovë që të paraqes një koment me shkrim për ankesën dhe, pas pranimit të saj, të kërkojë nga Ankuesi të paraqes komente të mëtejme.

3. Paneli mund t'i kërkoj Ankuesit të paraqes ndonjë informacion faktik, dokument apo material tjetër i cili konsiderohet të jetë i rëndësishëm.

Rregulla 31. Komentet mbi papranueshmërinë

Çdo koment i bërë nga EULEX-i në Kosovë mbi papranueshmërinë e ankesës duhet të jenë me shkrim dhe të paraqitet sipas Rregullës 30.

Rregulla 32. Vendimi mbi pranueshmërinë

Pas pranimit të komentit me shkrim nga ShM dhe përgjigjet e mundshme, Paneli mund të vendosë mbi çështjen e pranueshmërisë së ankesës. Rregulla 29, paragrafi 2 do të zbatohet *mutatis mutandis*.

Rregulla 33. Procedura me shkrim dhe me gojë

1. Shqyrtimet e Panelit kryesisht do të bazohen në procedurën me shkrim.

2. Paneli mund të kërkojë nga Ankuesi që të parashtrojë dëshmi të tjera dhe komente me shkrim.

3. Nëse Paneli konstaton se ankesa nuk mund të shqyrtohet vetëm në bazë të parashtrimit me shkrim, por që ky shqyrtim kërkon edhe një paraqitje me gojë, Paneli mund të pranojë një paraqitje të tillë me gojë. Kryetari do të organizojë dhe drejtojë paraqitjet me gojë. Anëtarët e Panelit mund t'ju parashtrojnë pyetje personave gjatë paraqitjeve të tyre me gojë përpara Panelit.

Rregulla 34. Paraqitja e konkludimeve

Pas përfundimit të shqyrtimit të ankesës, Paneli ia paraqet konkludimet e veta ShM, duke përfshirë edhe vendimin e Panelit mbi pranueshmërinë. Aty ku është e nevojshme, Paneli do të jap rekomandimet jo detyruese për veprime korrigjuese.

Rregulla 35. Forma e konkludimeve

1. Konkludimet do të përmbajnë:

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

- a. Emrat e anëtarëve pjesëmarrës në Panel;
- b. Datën e vendimit;
- c. Përshkrimin e Ankuesit dhe të përfaqësuesit të tij/saj;
- d. Një përmbledhje e procedurës së ndjekur;
- e. Një deklaratë për faktet e lëndës;
- f. Një përmbledhje e parashtrësive të pranuar;
- g. Arsyet në pikat e ligjit;
- h. Mendimin e Panelit;
- i. Aty ku është e nevojshme, rekomandimet për veprime korrigjuese.

D. Dëshmia

Rregulla 36. Dëshmia mbi të cilën bazohen konkludimet dhe vendimet

Paneli do t'i bazojë vendimet dhe konkludimet e veta vetëm mbi dëshmi e cila konsiderohet të jetë e lidhur me ankesën, duke përfshirë dëshminë e mbledhur me vetiniciativën e tij.

Rregulla 37. Parashtrimi i dëshmisë shtesë nga Ankuesi

Ankuesi mund të parashtrojë dëshmi shtesë në çdo kohë gjatë procedimit. Mirëpo, Paneli mundet, kur kjo është e nevojshme për kryerjen e duhur të detyrave, të vendos një afat kohor për parashtrimin e dëshmive të tilla.

E. Nënshkrimi, shpërndarja, njoftimi dhe publikimi i vendimeve dhe konkludimeve

Rregulla 38. Nënshkrimi

Vendimet dhe konkludimet do të nënshkruhen nga Kryetari dhe Zyrtari i Lartë Ligjor.

Rregulla 39. Shpërndarja

Vendimet dhe konkludimet do të shpërndahen në formë të shkruar.

Rregulla 40. Njoftimi

Ankuesi dhe SHM do të njoftohen mbi vendimet dhe konkludimet.

Rregulla 41. Publikimi

Vendimet dhe konkludimet do të publikohen me kohë në www.hrrp.eu në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, përveç nëse publikimi i tyre mund të ndikojë në efikasitetin operacional të Misionit apo në sigurinë e personelit të Misionit. SHM do të vendos për rastet e tilla pas konsultimit me anëtarët e Panelit.

F. Rishqyrtimi i pranueshmërisë së ankesës, korrigjimi dhe ndreqja e gabimeve të konkludimeve

Rregulla 42. Rishqyrtimi i pranueshmërisë së ankesës

1. Ankuesi, në rast të zbulimit të ndonjë fakti, i cili për nga natyra e tij mund të ketë ndikim vendimtar në pranueshmërinë e ankesës dhe i cili, kur është shpërndarë vendimi mbi papranueshmërinë, ka qenë i panjohur për Panelin dhe me arsye nuk ka qenë i njohur për Ankuesin, ai/ajo mund të kërkojë nga Paneli, brenda afatit kohor prej një muaji, pasi Ankuesi kishte fituar njohuri mbi faktin, që të rishqyrtojë pranueshmërinë e ankesës.

2. Në kërkesë duhet të saktësohet vendimi përkatës mbi papranueshmërinë dhe duhet të përmbajë informacion të nevojshëm për të treguar se kushtet që përmban paragrafi 1 janë në përputhje me të. Kërkesës duhet t'i bashkangjiten kopjet e të gjitha dokumentacioneve mbështetëse.

3. Paneli mund të hedh poshtë kërkesën, nëse nuk ekziston ndonjë arsye për të arsyetuar marrjen e saj parasysh.

Rregulla 43. Kërkesa për korrigjimin e konkludimeve

1. Ankuesi, në rast të zbulimit të ndonjë fakti, i cili për nga natyra e tij mund të ketë ndikim vendimtar në pranueshmërinë e ankesës dhe i cili, kur është shpërndarë vendimi mbi papranueshmërinë, ka qenë i panjohur për Panelin dhe me arsye nuk ka qenë i njohur për Ankuesin, ai/ajo mund të kërkojë nga Paneli, brenda afatit kohor prej një muaji, pasi Ankuesi kishte fituar njohuri mbi faktin, që të korrigjojë konkludimet.

2. Në këtë kërkesë duhet të saktësohen konkludimet për të cilat kërkohet korrigjimi dhe ajo duhet të përmbajë informacion të nevojshëm për të treguar se kushtet që përmban paragrafi 1 janë në përputhje me të. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet nga një kopje e të gjitha dokumenteve mbështetëse.

3. Paneli mund të hedh poshtë kërkesën, nëse nuk ekziston ndonjë arsye e cila arsyeton marrjen e saj parasysh.

4. Nëse Paneli nuk e hed poshtë kërkesën, ai do t'ia komunikojë vendimin për këtë Ankuesit dhe Shefit të Misionit dhe do t'i ftojë ata që të parashtrajnë komentet e tyre me shkrim brenda afatit kohor të caktuar nga Paneli.

Rregulla 44. Përmirësimi i gabimeve dhe revidimi redaksional

Pa paragjykime ndaj Rregullës 42 dhe 43, Paneli mund të përmirësojë gabimet që janë të natyrës administrative, gabimet në kalkulim apo gabimet tjera të dukshme, në bazë të propozimit të vet apo në bazë të kërkesës nga Ankuesi apo ShM. Kërkesa duhet të dorëzohet brenda një muaji, pas shpërndarjes së konkludimeve.

G. Devijimi

Rregulla 45. Devijimi për rastet individuale

Dispozitat e këtij kapitulli nuk e ndalojnë Panelin nga devijimi gjatë konsiderimit të një rasti të veçantë, aty ku është e nevojshme dhe për kryerjen e duhur të detyrave të tij.

Kapitulli 5. Dispozitat përfundimtare

Rregulla 46. Çështjet jo të udhëhequra nga Rregullorja e punës

Çështjet jo të udhëhequra nga Rregullorja e punës do të vendosen nga Paneli duke respektuar funksionin e vet si Panel për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, parimet për një seancë të drejtë në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Veprimit të Përbashkët.

Rregulla 47. Versionet e gjuhëve të Rregullores së punës

Kjo Rregullore e punës është miratuar në gjuhën angleze, që paraqet versionin origjinal. Teksti do të përkthehet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

Ndryshuar dhe miratuar nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në Prishtinë, Kosovë, më 9 qershor 2010.

Anëtarët e Panelit

Ms. Magda Mierzevska (Anëtar)

.....

Mr. Antonio Balsamo (Anëtar)

.....

Mr. Francesco Florit (Anëtar)

.....

Ms. Gabriele Gaube (Anëtar zëvendësues)

.....

Mr. John J. Ryan (Zyrtar i Lartë Ligjor)

.....

Shtojca 4 Mendimi i Komisionit të Venecias (pjesë e shkëputur)

Rreth mekanizmave ekzistues për të Shqyrtuar Respektimin e Standardeve të të Drejtave të Njeriut të Akteve nga UNMIK-u dhe EULEX-i në Kosovë

Miratur nga Komisioni i Venecias në seancën plenare (Venecias, 17-18 dhjetor 2010)

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i EULEX-it në Kosovë

Parathënie

1. Në mendimin e vet të vitin 2004 rreth gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë, Komisioni i Venecias ka theksuar se kur një organizatë ndërkombëtare mban funksione ekzekutive që janë të ngjashme me të një shteti, atëherë ajo nuk duhet të përjashtohet nga shqyrtimi i pavarur ligjor, në veçanti prej një sistemi të pavarur që shqyrton respektimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.¹
2. Në raportin e tij rreth Misionit të tij Special në Kosovë më 2009, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës në lidhje me EULEX-in ka deklaruar:

“Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit EULEX-i gjithashtu mund të shqyrtoj mundësinë e themelimit të një mekanizmi të pavarur llogaridhënës. EULEX-i ka mundësi t’i ushtroj disa funksione ekzekutive, edhe nëse ato nuk përdoren shumë shpesh. Tani për tani, ankesat që janë bërë kundër personelit të EULEX-it janë duke u trajtuar nga brenda. Ekzistojnë disa mundësi për mekanizmat llogaridhënës të EULEX-it. Një mundësi është që EULEX-i të merr modelin e tanishëm të Panelit Këshillues për të Drejtat e Njeriut; një tjetër është që ankesat mund të trajtohen nga Institucioni i Ombudspersonit. Mundësia e tretë është që EULEX-i ta krijoj mekanizmin e vet të pavarur. Komisioneri kërkon nga EULEX-i të krijoj një mekanizëm efektiv llogaridhënës si një çështje me prioritet. Një mekanizëm i tillë do të kishte autoritet të hetonte plotësisht çfarëdo pretendimi për shkelje dhe keqëbërje, dhe se përfaqësuesit e EULEX-it do t’i nënshtroheshin hetimeve nga një organ i pavarur dhe transparent. Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar gjithashtu mund të shqyrtoj përparësitë e një mekanizmi të tillë llogaridhënës.”²

3. Siç është nënvizuar nga Komisioneri, EULEX-i ka disa funksione të caktuara ekzekutive (shih paragrafin 17 të paraqitur më lart). Iu është dhënë imunitet ndaj procedurave vendore ligjore dhe administrative, që është një fenomen standard për misionet ndërkombëtare dhe diplomatike. Kjo rezulton me atë se legjislacioni vendor nuk mund të zbatohet kundër EULEX-it, apo anëtarëve të saj të stafit. Sidoqoftë, EULEX-i dhe anëtarët e saj të stafit duhet të respektojnë legjislacionin vendor dhe nëse stafi i saj nuk e respekton atë, imuniteti i tyre mund të tërhiqen dhe ata mund të ndiqen penalisht në shtetin prej nga vijnë.

¹ CDL(2004)033, paragrafi 91.

² Raporti i Këshillit të Komisionarit Evropian për Misionin Special të të Drejtave të Njeriut në Kosovë 23 - 27 mars 2009, paragrafi 80, në <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1466279>.

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

4. Sipas dokumentit³ të EULEX-it, llogaridhënia përfshinë elementet (ligjor dhe disiplinor) të brendshëm dhe të jashtëm llogaridhënës operacional, që zbatohen edhe ndaj popullit të Kosovës dhe popullit të Bashkimit Evropian. Llogaridhënia e jashtme përfshinë përgjegjësinë politike ndaj Shteteve Anëtare të BE-së dhe shteteve të treta pjesëmarrëse, llogaridhënia kundrejt autoriteteve politike në Kosovë, përgjegjësia shoqërore ndaj popullit të Kosovës dhe përgjegjësia financiare (misioni është përgjegjës ndaj Komisionit Evropian, që i mbikëqyr aspektet financiare të misionit, dhe jo drejtpërdrejtë ndaj BE-së.
5. Sa i përket llogaridhënies së jashtme të të Drejtave të Njeriut, BE-ja ka vendosur të promovoj themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut për ankesat nga secili person që pretendon se është viktimë e shkeljeve të të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit kësaj ekzekutiv.

Struktura

6. PShDNj është themeluar në pajtim me vendimin e Bashkimit Evropian të datës 20 nëntor 2009.⁴ Përshkrimi i PShDNj gjendet në uebfaqe dhe është si më poshtë:

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli)

Parathënie

Veprimi i Përbashkët që cili themelon misionin EULEX në Kosovë sikurse edhe CONOPS dhe OPLAN i Misionit parashohin se Misioni duhet të respektoj standardet e të drejtave të njeriut të pranuar ndërkombëtarisht. Kjo do të bëhet përmes një mekanizmi të jashtëm, Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, i cili e plotëson përgjegjësinë e plotë të Misionit, tashmë duke përfshirë Njësien për Hetime të Brendshme dhe Sigurimin ndaj Palës së Tretë. Prandaj, PSHDNJ u themelua me 29 tetor 2009 në përputhje me dispozitat e Veprimit të Përbashkët.

Anëtarët

Më datën 4 maj 2010, U.D i Shefit të Misionit EULEX, z. Roy Reeve, emëroi tre anëtarët e përzgjedhur për PSHDNJ të Misionit EULEX në Kosovë. Anëtarët janë:

1. Z. Antonio Balsamo, shtetas italian,
2. Znj. Magdalena Mierzevska, shtetase polake,
3. Z. Francesco Florit, shtetas italian, gjykatës i EULEX-it.

Anëtarët e PShDNj janë emëruar për një mandat njëvjeçar me mundësi të vazhdimit. Përveç këtyre anëtarëve, znj. Gabriele Gaube, shtetase Gjermane, është emëruar me 04 Maj, 2010 si anëtare zëvendësuese. Ajo është gjykatëse e EULEX-it, e cila do të zëvendësojë z. Florit, në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit për shkak të punës së tij si gjykatës i EULEX-it.

³ <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/Accountability/EULEX-Accountability-05.01.2010.pdf>

⁴ “Koncepti llogaridhënës” i PShDNj, i miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian në nëntor 2009 është një dokument për përdorim të kufizuar. Edhe pse Komisioni i Venecias ndien për obligim të respektoj këtë kufizim, ajo është e mendimit se baza ligjore e PShDNj duhet të bëhet e njohur për publikun për shkak të transparencës dhe qasjes së mekanizmit.

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

PShDNj përkrahet në mënyrë të përhershme nga Sekretariati i cili është i vendosur në qendër të Prishtinës, në rrugën Rrustem Statovci, nr. 29.

Mandati

Mandati i PShDNj është për të shqyrtuar ankesat nga personat që ankohen të kenë qenë viktimë të shkeljeve të drejtave të njeriut nga ana e Misionit EULEX në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit të tij ekzekutiv. PShDNj është i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta të cilat do t'i kryejë në mënyrë të ndershme dhe të paanshme.

Juridiksioni

PShDNj shqyrton ankesat që kanë të bëjnë me këto shkelje të pohuara e të cilat kanë ndodhur në Kosovë prej datës 9 dhjetor 2008. Ankesat duhet të dorëzohen në PShDNj brenda tre muajve nga 9 Qershori 2010, kur PShDNj-ja është bërë operacional ose brenda gjashtë muajve nga data e ndodhjes së shkeljes së pohuar, varësisht se cila është më e favorshme për ankuesin.

Procedura

PShDNj shqyrton ankesat në bazë të informacionit me shkrim dhe mund të pranojë edhe paraqitjet me gojë.

Ankuesi

Çdo person mund të parashtrojë ankesë, përveç personelit të EULEX-it në Kosovë, i cili/cila deklaron se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i. Ankuesi mund të përfaqësohet para PShDNj përmes avokatit apo përfaqësuesit tjetër të zgjedhur sipas dëshirës.

Ankesa

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga ankuesi. Ankesa duhet të përmbajë të gjitha hollësitë përkatëse për kontaktim dhe faktet e shkeljes së deklaruar me të gjitha dëshmitë dokumentuese. Nëse ekzistojnë vendime të mëhershme për lëndën, atëherë ato duhet t'i bashkëngjiten ankesës.

Konkludimet

PShDNj ia paraqet konkludimet e veta Shefit të Misionit, dhe aty ku është e nevojshme, jep rekomandime jo obliguese për veprime korrigjuese. Rekomandimi nuk mund të rezultojë me kompensim me të holla. Konkludimet dhe rekomandimet bëhen publike.

7. PShDNj u bë operativ në 9 qershor 2010. Gjatë seancës së tij të parë (09-11 qershor 2010) Paneli miratoi rregulloren e vet të punës.⁵

8. Sipas të dhënave të disponueshme më 15 dhjetor 2010,⁶ 16 raste kanë qenë të regjistruar, 6 prej të cilave janë shpallur të papranueshme.

Vlerësimi

9. Komisioni i Venecias e ka kufizuar veten në vlerësimin e mekanizmit monitorues në lidhje me funksionet ekzekutive të EULEX-it. Ajo mirëpret themelimin e Panelit si një mekanizëm llogaridhënës i EULEX-it në lidhje me

⁵ <http://www.hrrp.eu/docs/ROP.pdf>

⁶ <http://www.hrrp.eu/Statistics.php>; vizituar së fundi më 20 dhjetor 2010.

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

shkeljet e mundshme të drejtave të njeriut të kryera nga EULEX-i gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve.

10. Raportuesit janë konsultuar gjatë fazave përgatitore në verën e vitit 2009. Komisioni i Venecias mirëpret se disa nga rekomandimet e tyre janë marrë parasysh në përgatitjen e konceptit të dokumentit.

11. PShDNj duket të jetë përgjithësisht në përputhje me rekomandimet që Komisioni i Venecias kishte formuluar në vitin 2004 në lidhje me një mekanizëm konsultativ i për shqyrtimin e të drejtave të njeriut për Kosovën. Komisioni i Venecias dëshiron të theksojë, megjithatë, se këto rekomandime janë bërë në një kontekst të një situatë pas konfliktoze emergjente me institucionet që veprojnë vetëm pjesërisht. Sot mbretëron një situatë ndryshe në Kosovë, dhe në këtë drejtim, Komisioni i Venecias është i mendimit se, për aq kohë sa veprimet e EULEX-it janë veprime përkrahëse apo korrigjuese brenda një situatë përgjithësisht të qetë, EULEX-i duhet të vihet nën një shqyrtim më të rrepta.

12. Komisioni i Venecias vëren se PShDNj është bërë operacional dhe tashmë ka vetëm disa javë që prej themelimit të saj, filloi të shqyrtojë ankesat, por ka një faqe interneti ku vendimet janë postuar menjëherë në tri gjuhë dhe ka kryer një fushatë të madhe në terren për të rritur vetëdijen rreth mandatit dhe funksioneve të tij në mesin e publikut të gjerë. Komisioni i Venecias është i mendimit se qëndrimi i tillë efikas dhe proaktiv meriton të lavdërohet dhe të inkurajohet.

13. Pasi në ndërkohë Paneli është ngritur, nuk ka pikë të vogël në përsëritjen e të gjitha sugjerimet që raportuesit e kishte bërë në verën e vitit 2009. Komisioni i Venecias do të kufizoj veten në vënë në dukje pikat kryesore që në qëndrimin e saj do të meritojnë për rishqyrtim.

Pavarësia e Panelit

14. PShDNj është i përbërë nga tre persona ndërkombëtarë me një ekspertizë të dëshmuar në të drejtat e njeriut, një prej tyre është një gjyqtar i EULEX-it. Ata janë të emëruar pas një procedure konkurruese nga Shefi i Misionit (për gjyqtar të EULEX-it në konsultim me Kryetarin e Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it). Ata nuk janë në zinxhirin komandues të shefit të Misionit. Në mënyrë që PShDNj të shihet me një kuptim objektiv si i pavarur dhe si ushtrues i funksioneve të tij me paanësi, Komisioni i Venecias është i mendimit se në procedurën e emërimit hyrjet nga jashtë janë të rëndësishme. Është i mendimit se dy anëtarë të jashtëm të panelit duhet të emërohen nga shefi i Misionit në konsultim me Kryetarin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut apo Kryetarin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

15. Anëtarët e panelit tani për tani janë emëruar për një vit. Sipas njoftimit të dhënë nga misioni i EULEX-it, mandati i tyre mund të zgjatet “me kërkesë të anëtarit të Panelit”. Komisioni i Venecias është i mendimit se, për hir të pavarësisë objektive, kohëzgjatjen e mandatit fillestar të anëtarëve të panelit duhet të zgjatet automatikisht brenda afatit të mandatit të EULEX-it.

Mandati

16. Mandati i PShDNj është formuluar si vijon: “*për të shqyrtuar ankesat nga çdo person, përveç personelit të EULEX në Kosovë, që pretendojnë të jenë viktime të shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të ekzekutiv të ULEX-it në Kosovë. Paneli nuk do të merret me shqyrtimin e seancave gjyqësore të gjykatave të Kosovës.*”

“Sipas mendimit të Komisionit, mandati në lidhje me sektorin e drejtësisë është i paqartë, por tani do t’i lihet “praktikës” së PShDNj për të sqaruar se çfarë çështje mund të dorëzohen në Panel.

Natyra jo-detyruese e vendimeve të PShDNj

17. PShDNj kishte funksione këshillëdhënëse, gjetjet dhe rekomandimet e tij janë jo-detyruese. Shefi i Misionit mund të vendos që mos të zbatohet rekomandimi. Komisioni i Venecias mendon se vendimet e mundshme nga Shefi i Misionit për mos t’i zbatuar konkluzionet e Panelit duhet të jenë të duhura dhe të motivuara publikisht. Do të ishte e pëlqyeshme nëse kjo do të shpjegohej në mënyrë të qartë.

Rekomandimet e PShDNj

18. PShDNj mund të sugjerojë veprime korigjuese si: verifikimi i fakteve, trajtimi i shkakut të shkeljes së të drejtave të njeriut, veprime konkrete për të shmangur shkeljet e të ngjashme në të ardhmen, përmirësimin e organizimit ose ushtrimit të aktiviteteve etj.

19. Kjo është parashikuar shprehimisht se “shqyrtimi nga paneli nuk mund të rezultojnë në rekomandime për kompensim”. Në pajtim me konceptin e përgjegjësisë së EULEX-it, të gjitha kërkesat për kompensimin financiar për dëmin e supozuar të shkaktuar nga EULEX-i në Kosovë, si rregull e përgjithshme, do të trajtohen përmes mbulimit të sigurimit. Çdo kërkesë për kompensim financiar duhet të adresohet në këtë mënyrë te Shefi i Misionit, në mënyrë që ta shoh se “kërkesa është trajtuar në mënyrë të duhur”.

20. Komisioni i Venecias është i mendimit se, në parim, *restitutio in integrum* (kthimi në gjendjen e mëparshme) është mënyra më e përshtatshme për korigjimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Mundësia që PShDNj të rekomandojë veprime korigjuese duke larguar efektet dhe shkaqet e është e rëndësishme. Megjithatë, në disa raste mjeti më efektiv është kompensimi financiar, i cili nuk mund të rekomandohet nga PShDNj. Në raste të tilla do të jetë e mundur të kërkohet kompensim monetar, të paktën për dëmin material, në bazë të skemës së Palës së Tretë të EULEX-it. Megjithatë, Komisioni i Venecias thekson se procedura e skemës së sigurimit nuk duhet të zgjatë tepër dhe të jetë e ndërlikuar. Në këtë drejtim vihet në dukje se Shefi i Misionit të EULEX-it është angazhuar që të shqyrtoj procedurat e sigurimit, për tu vërtetuar që procedurat e sigurimit të mbeten në fuqi.

Përfundimi

21. Komisioni i Venecias përsërit se është parim themelor i sundimit të ligjit dhe e domosdoshme për respektim të plotë dhe efektiv të të drejtave të njeriut që organizatat ndërkombëtare të cilat ushtrojnë funksione ekzekutive në Kosovë t'i nënshtrohen një mekanizmi monitorues për shqyrtimin e respektimit të të drejtave të njeriut.

22. Komisioni i Venecias mirëpret themelimin e Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut në nëntor të vitit 2007, në përgjithësi në përputhje me rekomandimet e saj të vitit 2004. Komisioni kërkon që ky Panel dhe UNMIK-u të gjejnë një zgjidhje, në mënyrë që mbi 450 raste që tani janë në pritje para Panelit të mund të përpunohen para se UNMIK-u të largohet nga Kosova.

23. Gjithashtu, Komisioni i Venecias mirëpret themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it në nëntor të vitit 2009, dhe inkurajon këtë Panel të mbaj qëndrimin e saj pro-aktiv. Megjithatë, Komisioni këshillon Këshillin e Bashkimit Evropian të rishqyrtojë disa prej veçorive të Panelit nga pikëpamja e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare.